



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 147/5 Prot.

Tiranë më, 20/04/2022

VENDIM

Nr. 14, datë 20.04.2022

Për

“Miratimin e amendimit të kontratës së nënshkruar me Shoqërinë Private të Sigurisë Fizike “Nazeri 2000” sh.p.k bazuar në ndryshimin e pagës minimale”

Në mbështetje të Vendimit Nr. 158, datë 12.03.2022 “Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pika 1; të kërkesës së SH. P. S. F. “Nazeri” 2000 Nr. 121 Prot, datë 04.04.2022, ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe bazuar në ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e tij të radhës Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e amendimit të kontratës së nënshkruar me Shoqërinë Private të Sigurisë Fizike “Nazeri 2000” sh.p.k të shpallur fituese për procedurën e prokurimit me objekt: Shtëpia e Arkeologëve në Parkun Arkeologjik të Apolonisë, Pojan, Fier (Shërbimi i ruajtjes së objektit) – Marrëveshje kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj.
2. Të rritet paga minimale mujore nga 30.000 në 32.000 lekë, në zbatim të Vendimit Nr. 158, datë 12.03.2022 “Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pika 1.
3. Ky ndryshim i pagës minimale të reflektohet për periudhën nga 01.04.2022-27.10.2022.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i ASA-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

EMIS CERAVA

